

## Situata, Pjesa 1

Luisi ishte kthyer në shtëpi nga misioni i tij për pothuajse dy vjet. Për shkak se ai shqetësohet rreth sigurimit të të ardhurave për një familje të ardhshme, ai ka vendosur të punojë me kohë të pjesshme ndërkohë që vazhdon shkollën. Koha e tij është e kufizuar, por atij i pëlqen ora e përjavshme mësimore e institutit dhe e bën atë një përparësi. Luisi zakonisht kontrollon mediat shoqërore dhe luan lojëra në autobus ose përpara orëve mësimore. Ai nuk ka takuar shumë vajza qëkurse është kthyer në shtëpi. I thotë familjes se ndien që do të ishte më mirë të priste për ta ndjekur seriozisht martesën derisa të ketë përfunduar shkollën. Ai mendon që nëse është e thënë të martohet më shpejt, kjo do të ndodhë.

Emë ndjek të njëjtën orë mësimore të institutit si Luisi, por nuk e ka takuar kurrë atë. Ajo zakonisht ulet me shoqet e saj dhe rrallëherë i flet dikujt tjetër. Atë e vënë në siklet takimi me burrat dhe dalja në takime në përgjithësi. Ajo shqetësohet se po të fillojë një marrëdhënie tjetër, do të përfundojë, si gjithë të tjera në të shkuarën. Është e lodhur emocionalisht dhe nuk ndien se ka energji të mjaftueshme që të nisë një marrëdhënie tjetër. Ajo e mbaroi shkollën para një viti dhe ka një punë me kohë të plotë. Shqetësohet se mund të mos e takojë kurrë të dashurin e saj të vërtetë ose të vulozet në tempull dhe vret mendjen nëse duhet të takohet me dikë tjetër jashtë Kishës.

Pasi ta lexoni situatën së bashku, diskutoni për pyetjet në vijim:

- Çfarë mendoni për shqetësimet e Luisit dhe të Emës?
- Duke marrë parasysh atë që mësuam nga pjesa 1 e materialit të përgatitjes, çfarë këshille mund të jetë e dobishme për Luisin? Çfarë këshille mund të jetë e dobishme për Emën?
- Nëse nuk keni folur tashmë rreth fragmenteve vijuese në diskutimin tuaj në grup, lexojini ato së bashku dhe diskutoni se si mund të lidhen ato me Luisin dhe Emën: Fjalët e Urta 3:5–6; 2 Nefi 22:2; Doktrina e Besëlidhje 58:26–28. Si e keni ushtruar ose si mund ta ushtroni besimin te Zoti në përpjekjet tuaja për të gjetur një shok ose shoqe të përjetshme?